

RE: Hasan Boshnjaku


(2)

and

Halim Boshnjaku

Halimi ka dale ne Jugosllavi 20 dite perpara vellat te tij. Kure kane ndejte ne Padinska Skela kane kerkue me dale ne liri-dalje dhe jane interesue menjihere per dy sportistat qe te njifeshin me ta se afermi. Ma vone dolen ne Hotel si gjithë te tjeret dhe u hodher menjihere ne veprimtari. I madhi (Hasani) duke pare Xhelal Sukniqin si njeri me temperament te qete dhe i dhembeshem per familje, arriti te depertoit ne shpirtin e tij duke i premtuar qe po te kethehet ne Shqipni nuk do t i baj vaki asgje dhe qeverija do ta fali. Njikohesis edhe njerezit e tij qe ja kane internue mbasi hiku ai do t'ia rikethejshin ne shtepi. Qellimi i tyne ishte qe t'i kethejshin ne Shqipni dhe prej andej keta te dy te thojshin se jugosllavet na kane vjedhur nga autobuzi. Ma vone kane dashte me ba edhe presjon, por ne fund kure e mori vesht Aleksander Kondo qe te dy keto u nisen me i vra. Nderhyra une (Lulzim Murati) dhe nuk i lash qe te bajshin nji akt te tille. Lajmerova policine dhe ata menjihere i arrestuen. I pari pranoi se punonte per Sigurimin shqiptar c'prj vjetit 1974, kurse i dyti ashte ne hetim akoma. Si Kondo, ashtu Sukniqi i kane vizat, por qeverija jugosllave i ka ndaluar provizorisht per t'i pasu si deshmitare ne gjyggj per te dy vellezerit Boshnjaku.

Lulzim Murati



New York  
on October 7, 1985